



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.08.2023)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)*</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

3. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*

Shënim: Nuk marrin pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu* dhe *z. Dritan Hallunaj. Znj. Fatmira Luli* nuk ndodhet online në momentin e hedhjes në votim të aktit.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), faza e dytë, për sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Mbledhja plenare e datës 24.08.2023 drejtohet nga Kryetarja e Këshillit dhe ka për objekt miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), faza e dytë, për sistemin gjyqësor.

I jepet fjala drejtorit të departamentit z. Haxhiu për të relatuar shkurtimisht përmbajtjen e fazës së dytë të kërkesave buxhetore.

Xhevdet Haxhiu: Struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit në KLGJ në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e gjykatave dhe teknologjisë së informacionit ka përgatitur dokumentin përfundimtar të kërkesave buxhetore (PBA) për periudhën 2024 – 2026, faza e dytë, për sistemin gjyqësor, ku përfshihet buxheti i KLGJ-së, i QTI-së dhe i gjykatave të tre niveleve.

Hartimi i dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm (PBA) 2024–2026, për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit (QTI), prezanton kërkesat buxhetore për fonde buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor, duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të KLGJ–së.

Deklarata e misionit vjen në funksion të përgatitjes së kërkesave buxhetore, përcaktohet si i lidhur ngushtë me vizionin e saj. Këshilli i Lartë Gjyqësor në Planin Strategjik, ka të përcaktuar qartë: Vizionin, Misionin, Vlerat, Synimet dhe Objektivat. Deklarata e Misionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të përgatitjes së kërkesave buxhetore, PBA 2024 – 2026, është: Të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon ekselencë dhe meriton besimin e publikut.

Gjithashtu në këtë dokument është përcaktuar edhe misioni, vizioni i KLGJ–së, politikën e programit, qëllimin e politikës së programit buxhetor i cili konsiston në punën për të ndërtuar një sistem gjyqësor funksional, efikas, llogaridhënës dhe novator, duke zbatuar praktikat më të mira ndërkombëtare, mbështetje dhe instrumente që përmirësojnë ofrimin e shërbimeve gjyqësore, efikasitetin e administrimit të gjykatave, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe që sjellin përfitime të prekshme për qytetarët.

Parashtrime të detajuara mbi kërkesat buxhetore dhe tavanet, sipas programeve dhe artikujve kryesore të shpenzimeve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet strukturës përgjegjëse për administrimin e buxhetit, ka përgatitur dokumentin përfundimtar të kërkesave buxhetore (PBA) për periudhën 2024 – 2026 për sistemin gjyqësor, faza e dytë, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesat buxhetore, për fazën e dytë teknike, janë përgatitur duke pasur parasysh si tavanet përfundimtare të miratuara, ashtu edhe historikun e realizimit të shpenzimeve sipas programeve, gjatë vitit buxhetor 2022 dhe në buxhetin e miratuar për vitin 2023.

Tavanet përfundimtare, të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024–2026, janë miratuar me VKM nr. 436, datë 19.07.2023, i ndarë në tre programe buxhetore: - Programi 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. – Programi 01140 – “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI). –

Programi 03310 – “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Kërkesa buxhetore e sistemit gjyqësor, për vitin 2024, në total janë programuar në shumën prej 7,331,450 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor, krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara për sistemin gjyqësor për vitin 2023 që është në shumën 4,362,600 mijë lekë, janë më të larta në shumën 2,968,850 mijë lekë ose afërsisht 68 % më shumë, rritje e cila ka ardhur kryesisht nga rritja e shpenzimeve të personelit si rrjedhojë e ndryshimit të pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), dhe rritjes së nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të punonjësit të administratës në shërbimin civil gjyqësor dhe të punonjësve të tjerë gjyqësorë nëpër gjykata.

Kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor, për të tre programet buxhetore, krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme që të gjithë e kanë përpara të shpërndarë.

Kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor (KLGJ–në, Gjykata dhe QTI) për vitin 2024, janë programuar në shumën prej 7,331,450 mijë lekë, ndërsa tavanet përfundimtare të miratuara janë në shumën prej 3,885,650 mijë lekë, pra kërkesat buxhetore për vitin ushtrimor 2024, janë më të larta se tavanit i miratuar në shumën 3,445,800 mijë lekë, ose në masën 89 % më shumë sesa tavanët e miratuar.

Kërkesat buxhetore për programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, zënë 7 %, të totalit të kërkesave për sistemin gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, janë në masën 0,3% e kërkesave buxhetore të sistemit gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin “Buxheti gjyqësor”, zënë masën më të madhe të kërkesave për sistemin gjyqësor në masën 92.7%.

Më poshtë jepet në mënyrë të detajuar për çdo program kërkesat buxhetore.

Programi 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”,

Në këtë program përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kërkesat buxhetore për këtë program janë bërë sipas pemës së programit ku është përshkrimi, qëllimi i politikës së programit, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektiv, produktet e programit të cilët janë

të lidhur ngushtë me treguesit e performancës dhe janë të ndara sipas grup artikujve të shpenzimeve.

Kërkesat buxhetore për këtë program janë programuar në shumën 521,150 mijë lekë dhe janë më shumë se tavanët e miratuara në shumë 195,000 mijë lekë. Edhe kjo vlerë ka ardhur si rezultat i rritjes së pagës së magjistratëve dhe të administratës civile në KLGJ për arsye sepse duhet të theksoj që rritja e pagave në muajin prill të këtij viti për të gjithë punonjësit nuk është reflektuar në tavanët e miratuara nga Ministria e Financave dhe Këshilli i Ministrave për këtë fazë të hartimit të PBA-së.

Shpenzimet korrente për këtë program janë programuar në shumën prej 419,650 mijë lekë dhe krahasuar me tavanët janë në shumën në 108,500 mijë lekë.

Kërkesa buxhetore në shpenzime personeli janë programuar në shumën 345,000 mijë lekë të cilat janë krahasuar me tavanin në shumën 108,500 mijë kjo për shkak të efektit të ndryshimit të pagës së magjistratëve, të nëpunësve civilë të KLGJ-së dhe punonjësve mbështetës.

Shpenzimet e pagave (në artikullin 600) janë në shumën 304,000 mijë lekë dhe janë programuar duke u bazuar në legjislacionin për pagat dhe pozicionet e punës sipas organigramës së institucionit të KLGJ-së, si dhe punonjësve me kontratë të përkohshme në punë, për vitin 2024.

Gjithashtu janë programuar edhe në artikullin 601 “Shpenzime për Sig. Shoqërore e Shëndetësore” në shumën 41,000 mijë lekë dhe kjo është mbi tavanin në shumën 10,000 mijë lekë tejkalim i cili vjen si rezultat i ndryshimit të nivelit të pagave.

Në shpenzime operative, artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” janë hartuar duke pasur parasysh buxhetin e miratuar për këtë artikull për vitin 2023 por edhe duke u mbështetur në nevojat dhe kërkesat e identifikuara në mënyrë analitike për çdo strukturë. Këto janë programuar për t’u përdorur në këto nënartikuj:

“Materiale zyre dhe të përgjithshme”; “Materiale dhe shërbime speciale”; “Shërbime nga të tretë”; “Shërbime transporti”; “Shpenzime udhëtimi”; “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme”; “Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale”; “Shpenzime të tjera operative”.

Në shpenzime të tjera korrente, artikulli 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, kërkesat janë programuar në shumën 1,500 mijë lekë dhe janë programuar

shpenzimet për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020.

Kërkesa buxhetore për shpenzime korrente, si për vitin 2025 ashtu edhe për vitin 2026, janë programuar në shumën prej 427,000 mijë lekë, ose 114,850 mijë lekë mbi tavanin e miratuar për vitin 2025 dhe 112,850 mijë lekë mbi tavanin e miratuar për vitin 2026.

Kërkesat buxhetore për shpenzime kapitale (investime), artikulli 230 + 231, “Investime/Aktive afatgjata jomateriale dhe materiale” kërkesat janë programuar në shumën 101,500 mijë lekë dhe janë mbi tavanin buxhetor në shumë 86,500 mijë lekë. Këto fonde janë programuar për blerje pajisje dhe software për plotësimin e nevojave për ushtrimin e aktivitetit të KLGJ-së.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Kodi i Projektit Blerje Pajisje kërkesat janë programuar në shumën 101,500 mijë lekë, duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e identifikuar dhe të programuara nga Sektori IT, për blerje pajisje për transferimin e sistemit RDA nga AKSHI në KLGJ, për pajisje për instalimin dhe konfigurimin e serverëve, pajisje të tjera të tjera teknike, sistem “exchange” server për hostimin e e-maileve zyrtare në infrastrukturën e IT të KLGJ-së dhe pajisje kompjuterike.

Nënartikulli 231.4320 “Pajisje të tjera teknike”, është në shumën në shumën 93,620 mijë lekë e cila konsiston në blerjen e për transferimin e sistemit RDA nga AKSHI në KLGJ në shumën 10,820 mijë lekë; në blerje pajisje për instalimin dhe konfigurimin e serverëve dhe “storage” për sistemin RDA, ku përfshihen “rack cabinet”, UPS, “switch”, “Next generation firewall” dhe pajisje të tjera IT për KLGJ, në shumën 8,800 mijë lekë; si dhe për blerjen e sistem “exchange” server për hostimin e e-maileve zyrtare në infrastrukturën IT të KLGJ, në shumën 74,000 mijë lekë.

Nënartikulli “Pajisje kompjuterike”, janë programuar në shumën 7,600 mijë lekë.

Në këtë grup shpenzimesh, janë programuar edhe “Pajisje të tjera zyre”, janë programuar në shumën 280 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për Shpenzime kapitale (investime), si për vitin 2025 ashtu edhe për vitin 2026, janë programuar në shumën prej 15,000 mijë lekë dhe janë në të

njëjtin nivel me tavanin e miratuara nga Ministria e Financës.

Programi 01140 - “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” –

Hartimi i dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm (PBA) 2024-2026, për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit (QTI), prezanton kërkesat buxhetore të QTI-së, duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të kësaj qendre.

Ky dokument është miratuar edhe në mbledhjen e bordit të QTI-së dhe është bazuar në deklaratën e misionit, ka të përfshirë qëllimin e politikës së programit, objektivat e programit, treguesit e performancës në nivel objektiv, produktin e programit.

Kërkesat buxhetore për programin e QTI-së paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme dhe është në vlerën totale 19,000 mijë lekë, të cilat janë të gjitha shpenzime korrente dhe krahasuar me tavanët përfundimtare të miratuara në shumën 12,900 janë më shumë në shumën 6,100 mijë lekë. Pjesën më të madhe në këto shpenzime korrente e zënë shpenzimet e personelit të cilat konsistojnë në rritjen e theksuar të pagave të punonjësve të fushës së teknologjisë së informacionit, miratuar në prill të këtij viti.

Në shpenzime personeli janë më shumë se tavanët në shumën 3,900 mijë lekë. Vetëm në shpenzime paga është 3,300 mijë lekë dhe në sigurime shoqërore është 1,500 mijë lekë më shumë se tavanët dhe vlera 600 mijë lekë, gjë të cilat do të jenë në konsideratë në konsultimin që do bëjmë me Ministrinë e Financës gjatë muajit shtator.

Në shpenzime operative, shuma e programuar është në vlerën 2,576 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara, në shumën 376 mijë lekë, janë më shumë, në shumën 2,200 mijë lekë. Këto janë programuar të përdoren për materiale zyre të përgjithshme, shërbime nga të tretë, shpenzime udhëtimi, shpenzime të tjera operative, shpenzime të tjera korrente artikulli 606 si dhe një pjesë të konsiderueshme në këto shpenzime e zënë honorarët e mbledhjeve të Bordit të QTI-së të parashikuara në vendimin përkatës Këshillit të Ministrave.

Kërkesat buxhetore për shpenzime korrente për vitin 2025, janë programuar në shumën 19,800 mijë lekë dhe për vitin 2026, janë programuar në shumën 20,500 mijë lekë.

Në “Shpenzime kapitale (investime 230 + 231)” kërkesa buxhetore për vitin 2024 janë programuar në shumën 0 lekë, duke ditur se të gjithë nevojat e kësaj qendre

plotësohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Programi 03310 – “Buxheti Gjyqësor”,

Në këtë program përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Përshkrimi i politikës për këtë program synon ofrimin efikas të shërbimeve dhe funksionim më të mirë të gjykatave, të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimin të infrastrukturës, nëpërmjet mbështetjes buxhetore, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e BE-së.

Në këtë program është përfshirë edhe qëllimi i politikës së programit, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektiv, produktet e programit të cilat janë të ndara sipas grup shpenzimeve dhe janë të lidhura me objektivat e këtij programi.

Kërkesat buxhetore për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, krahasuar me tavanet e miratuara, për fazën e dytë, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme që ju e keni të gjithë përpara. Pra siç shikohet, kërkesat buxhetore për vitin 2024 në këtë program janë programuar në shumën prej 6,791,300 mijë lekë, dhe krahasuar me tavanet e miratuara në shumën prej 3,546,600 mijë lekë, këto kërkesa janë më të larta se tavanin i miratuar në masën 91 % ose në vlerë absolute në shumën prej 3,244,700 mijë lekë.

Për sa më sipër, kërkesat buxhetore në këtë program, në mënyrë analitike dhe ndarë në artikuj e nënartikuj, sipas natyrës së shpenzimeve paraqiten si më poshtë:

Kërkesa buxhetore për shpenzime korrente (600+601+602+606), janë programuar në shumën prej 4,946,000 mijë lekë dhe krahasuar me tavanin e miratuar këto kërkesa janë më të larta se tavanin në masën 49% ose në vlerën absolute 1,634,400 mijë lekë.

Në shpenzime personeli, kërkesa buxhetore në shpenzime personeli, janë programuar në shumën 4,258,000 mijë lekë dhe krahasuar me tavanin, këto kërkesa janë më të larta se tavanin i miratuar në shumën 1,568,300 mijë lekë.

Programimi i fondeve në artikullin 600 “shpenzime paga” janë programuar në shumën 3,812,000 mijë lekë. Programimi i kërkesave buxhetore për shpenzime të pagave, gjatë fazës së dytë, është bërë për numrin 1,615 punonjës sipas strukturave organizative (gjyqtarë dhe administratë gjyqësore) si dhe për kërkesën për 89 punonjës shtesë në strukturën organike për administratën gjyqësore dhe 40 punonjës me kontratë të përkohshme. Programimi është bërë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për

përcaktimin e pagave të magistratëve dhe të administratës gjyqësore.

Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për muajin qershor 2023, numri i organikës në fakt, për gjykatat e të gjitha niveleve, rezulton të jetë 1311 punonjës, nga të cilët 298 magistratë në fakt dhe 1013 administratë gjyqësore.

Programimi për këtë fazë në shpenzimet e pagave janë përfshirë edhe kërkesat për 89 shtim pozicionesh nga strukturat organizative, kërkesa të cilat kanë ardhur nga 10 gjykata.

Gjithashtu në programimin e fondeve në shpenzime paga në buxhetin e gjykatave janë marrë parasysh edhe informacioni i ardhur nga burimet njerëzore për sa i përket pozicioneve të këshilltarëve ligjorë, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve të cilët do të përfundojnë Shkollën e Magistraturës, si dhe të profilit magistrat gjyqtar, të cilët do të përfundojnë Shkollën e Magistraturës në vitet 2024 – 2025 dhe 2026.

Efekti financiar i kërkesës për punonjës shtesë është në shumën 193,000 mijë lekë. Tavan i miratuar është më i ulët se kërkesa jonë në shpenzime personeli, në shumën 1,568,300 mijë lekë. Kjo diferencë vlerësoj se duhet të merret në konsideratë pasi në tavanët e miratuar (siç e cilësova edhe në dy programet e tjera) nuk është marrë parasysh ndryshimi i pagës së magistratëve dhe ndryshimi i pagës së nëpunësit civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë në gjykatat të cilat janë miratuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, me ligjin 33/2023, me vendimin e KM nr. 325/2023 dhe 326/2023. Këto ndryshime ligjore kanë një efekt të konsiderueshëm në rritjen e shpenzimeve të personelit për buxhetin gjyqësor.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj, se Këshilli i Lartë Gjyqësor në përgjigje të kërkesës së përcjellë nga MF për llogaritjen e efektit financiar të ndryshimit të pagës referuese të magistratit (gjyqtarit) në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, efektin financiar të përlllogaritur për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2022 për të gjithë magistratët dhe jomagjistratët të cilët preken nga ky vendim gjatë kësaj periudhe. Efekti ka qenë në shumën përafërsisht 1 miliard lekë dhe nuk është bërë pjesë e kërkesave tona buxhetore, pasi jemi në pritje të miratimit të fondeve shtesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi gjatë këtij viti vetëm një pjesë e këtyre fondeve është miratuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në artikullin 601 “Shpenzime për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore” janë programuar në shumën 446,000 mijë lekë, të cilat janë programuar duke u përlogaritur sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesat buxhetore për shpenzime korrente, për vitin 2025, janë programuar në shumën prej 4,968,000 mijë lekë dhe për vitin 2026, janë programuar në shumën prej 4,998,000 mijë lekë.

Në shpenzime operative

Në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” janë programuar në shumën 681,700 në mijë lekë. Krahasuar me tavanin e miratuar janë më shumë në shumën 65,900 mijë lekë. Kërkesat buxhetore për Shpenzime operative (602), janë programuar pas administrimit dhe shqyrtimit të kërkesave buxhetore të ardhura nga të gjithë gjykatat si dhe nevojat e identifikuara nga strukturat e KLGJ-së për mirëmbajtjen e sistemeve të ndryshme operative të gjykatave. Këto fonde janë programuar të përdoren sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet si më poshtë: “Materiale zyre dhe të përgjithshme”; “Materiale dhe shërbime speciale”; “Shërbime nga të tretët” që zënë pjesën më të madhe të fondeve të programuara në këtë artikull buxhetor, në shumën 415,900 mijë lekë. Këto janë programuar për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit të ruajtjes së sigurisë së godinave të gjykatave në shumën 105,000 mijë lekë; për mirëmbajtjes të sistemit ICMIS edhe mirëmbajtja e sistemit ARKIT në dy gjykata si Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes, suport teknik për programin m-files, programin sdml lot dhe portalin e-shërbime.klgj.al; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemit audio RDA nëpër sallat e gjyqit, si edhe mirëmbajtje dhe suport teknik për Programn Backup Chain; shërbimit të mirëmbajtjes së programit financiar; shpenzime për shërbimin e mirëmbajtjes së aplikacionit PAKS+; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të aplikacionit High Court Datacollection"; shpenzimet e shërbimit të Internet, Intranet për sistemin gjyqësor/ Lidhja dark Fiber / L2nternetit; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të klasifikuar; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemit të njoftimeve – E-Notification (Për Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë); shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të regjistrit të OJF + Infrastruktura fizike + Licensa (Për Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë); shpenzimet e shërbimit të

mirëmbajtjes të pajisjeve Disaster Recovery; shpenzimet e shërbimit të Testit të penetrimit për përforsimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe sistemet IT të KLGJ, gjykata dhe zyrat e shërbimit.

Ky grup shpenzimesh do të menaxhohet nga KLGJ-ja, dhe do të realizohet me procedurat e prokurimit të përqendruar për të gjitha gjykatat.

Janë programuar për t'u shpenzuar edhe në "Shpenzime transporti", "Shpenzime udhëtimi", "Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme", "Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale", "Shpenzime të tjera operative". Në këto shpenzime janë përfshirë edhe kërkesat buxhetore të ardhura nga Gjykata e Lartë të cilat konsistojnë në programimin e fondeve për mirëfunksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024, si shtesë në buxhetin e Gjykatës së Lartë në shumën 3,750 mijë lekë.

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe programimi për artikullin 606 shpenzime për transferta për buxhete familjare dhe individë janë programuar në shumën 6,300 mijë lekë dhe janë programuar për financimin e interesave të kredive për qëllime banimi për magjistratët gjyqtarë si dhe për shpenzime për rimbursimin e pagesës së limitit të telefonisë celulare për përfituesit sipas vendimit të KM dalë për këtë qëllim.

Kërkesat buxhetore në shpenzime korrente për vitin 2025, janë programuar në shumën prej 4,968,000 mijë lekë, për vitin 2026, janë programuar në shumën prej 4,998,000 mijë lekë.

Në shpenzime Kapitale, në artikullin 230 + 231, për vitin 2024 janë programuar në shumën 1,845,300 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh janë programuar bazuar në kërkesat e ardhura nga të gjitha gjykatat, databazës që disponon struktura përgjegjëse për investime, kryesisht për studime-projektme, ndërtime, rikonstruksione, pajisje të ndryshme IT, orendi dhe pajisje zyre, mjete transporti dhe pajisje të tjera teknike të paraqitura sipas nevojave Departamenti i IT-së në KLGJ të cilat janë në funksion të zhvillimit të programeve software për gjykatat e të gjitha niveleve.

Parashikimi i fondeve buxhetore në shpenzime kapitale, mbështetet gjithashtu në planet strategjike të zhvillimit të sektorit publik përkatës, në rastin tonë, planit të zhvillimit të infrastrukturës së gjykatave.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, në mënyrë analitike paraqiten, si

më poshtë:

Artikulli 230 “Investime/aktive afatgjata jo materiale” kërkesat buxhetore për vitin 2024 janë programuar në shumën 66,800 mijë lekë dhe konsistojnë në Kodin e projektit “Studime dhe Projektme”, të cilat kanë të bëjnë me hartimin e detyrave të projektimit dhe projekte të zbatimit për ndërtimin e gjykatave të reja, kryesisht për 5 gjykata (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit Berat, Durrës, Tiranë, Lezhë, Kukës). Gjithashtu kemi edhe një kërkesë nga Gjykata e Krimeve të Rënda në lidhje me një vlerë prej 2,000 mijë lekë për hartimin e projektit për instalimin e sistemit të ri BMS të menaxhimit të godinës.

Programi i menaxhimit të sistemeve të godinës BMS shumë i rëndësishëm për funksionin normal të aktivitetit të godinës pasi nëpërmjet këtij programi komandohen të gjitha sistemet e instaluar në godinë. Nëpërmjet këtij programi sigurohet informacion në çdo kohë për përmbajtjet që mund të ndodhin, për funksionimin e sistemit të ajrimit dhe të ventilimit, për mkz, etj.

Nga ana e gjykatës janë bërë testime të tregut që ofron mundësinë e ndërrimit të Sistemit BMS të godinës, i cili është instaluar që në krijim e godinës, në vitin 2008.

Prandaj është i domosdoshëm ndryshimi dhe përditësimi i tij, me instalimin e sistemeve bashkëkohore dhe për këtë paraprakisht nevojitet të krijohet një projekt nga ekspertë të fushës.

Përcaktimi i vlerave të fondit për hartim projektesh është bërë në mënyrë të përafërt dhe do të saktësohet në vijim të zhvillimeve për secilën prej objekteve të investimit. Bashkëlidhur për këtë është edhe dokumentacioni nr. 8.

Në grup shpenzimet e artikullit 231 që zënë pjesën më të madhe të kërkesave buxhetore, “Investime/aktive afatgjata materiale”, për vitin e parë buxhetor 2024, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 1,778,500 mijë lekë, dhe konsiston në pjesën më të madhe në projekte të ndërtimit të godinave të reja që shtrihen në disa vite buxhetore.

Në kodin e projektit “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë” kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 997,600 mijë lekë, nga të cilat, në artikullin “Ndërtime (ndërtesa administrative)”, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 816,000 mijë lekë. Këto kërkesa janë hartuar duke u bazuar në kërkesat e gjykatave, databazës që

disponon struktura përgjegjëse për investime ndërtimore dhe efektet financiare të cilat rrjedhin nga riorganizimi i gjykatave të cilat po i evidentojmë në mënyrë analitike si më poshtë:

Në këtë kërkesë përfshihen fondet për ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Lartë e cila, siç ju jeni në dijeni, për vitin 2023 është rakorduar fondi në 30,000 mijë lekë, për hartimin e projektit të zbatimit për godinën e re e cila shpresojmë të përfundojë brenda këtij viti buxhetor. Në vitet e kaluara u përfundua detyra e projektimit e cila është në funksion të projektit të zbatimit. Jemi në pritje të miratimit të sheshit që të bëhet e mundur realizimi i projektit të zbatimit dhe miratimi i fondeve për fillimin e godinës së re që siç jeni në dijeni është shumë e domosdoshme për Gjykatën e Lartë. Ky projekt investimi siç e kemi trajtuar edhe në projektbuxhetin e vitit të kaluar është parashikuar të ndërtohet në disa vite buxhetore dhe për vitin 2024 është programuar në shumën 450,000 mijë lekë, vijimi i tij në vitin 2025 në shumën 250,000 mijë lekë dhe përfundimi i objektit në vitin 2026 në shumën 400.000 mijë lekë.

Gjithashtu në këto kërkesa janë përfshirë edhe fondet për ndërtimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë, në shumën 603.000 mijë lekë.

Për Gjykatën Administrative të Apelit për vitin buxhetor 2023 është alokuar fondi prej 20,000 mijë lekë për hartimin e projektit të zbatimit dhe aktualisht ka përfunduar detyra e projektimit për këtë godinë dhe jemi në pritje të miratimit të sheshit të ndërtimit për të bërë të mundur fillimin e projektit të zbatimit për këtë vit buxhetor.

Projekti i ndërtimit për godinën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është përfshirë edhe në IPA 3, për vitin 2024. Buxheti i llogaritur në mënyrë të përafërt për këtë investim është vlerësuar të jetë 603.000 mijë lekë.

Po ashtu, ky projekt është pjesë e Planit të Veprimit të zbatuar për Strategjinë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2021–2025, (përcaktuar në objektivin 2.4), miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.823, datë 24.12.2021.

Realizimi i këtij projekti është programuar të realizohet në disa vite buxhetore. Për vitin 2024 është programuar në shumën 303,000 mijë lekë dhe të vijojë gjatë vitit 2025 në shumën 300,000 mijë lekë kur parashikohet edhe përfundimi i këtij projekti investimi.

Në këtë grup shpenzimesh është përfshirë edhe ndërtimi i Gjykatës së Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, vlera totale e investimit është programuar në shumën 286.400 mijë lekë. Të gjithë jemi në dijeni për rëndësinë dhe kushtet në të cilën ushtron funksionin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Kështu që për këtë vit është miratuar fondi për projektin e zbatimit që shpresojmë të realizohet. Për vitin 2024 është programuar fondi prej 63,000 mijë lekë, për vitin 2025 është programuar fondi 100,000 mijë lekë dhe përfundimi i këtij projekti investimi i kalon vitit 2026 në shumën 123,400 mijë lekë.

Edhe për vitin buxhetor 2025 janë programuar të ndërtohen (gjithmonë në kushtet nëse do të realizohen projektet e zbatimit gjatë vitit 2024) edhe godinat e gjykatave si më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, vlera totale e investimit është programuar në shumën 160,500 mijë lekë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, vlera totale e investimit është programuar në shumën 333,480 mijë lekë. Realizimi i saj është shtrirë në disa vite.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, vlera totale e investimit është programuar në shumën 110,500 mijë lekë. Edhe ky projekt është i shtrirë në dy vite buxhetore.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, vlera totale e investimit është programuar në shumën 233,140 mijë lekë. Edhe ky projekt është i shtrirë në dy vite buxhetore 2025–2026.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vlera totale e investimit është programuar në shumën 1,500,000 mijë lekë. Edhe kjo është parashikuar të realizohet duke shpresuar në realizimin e projektit të zbatimit do fillojë implementimin ndërtimi i godinës në vitin 2025 në shumën 500,000 mijë lekë vijimi i tij në vitin 2026 në shumën 600,000 mijë lekë dhe përfundimi i këtij projekti investimi i kalon vitit 2027 në shumën 400.000 mijë lekë.

Për vitin 2026 parashikohet të ndërtohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, vlera totale e investimit është programuar në shumën 290,000 mijë lekë.

Në këtë grup shpenzimesh përfshihen gjithashtu edhe “Rikonstruksione të tjera

ndërtimore” të cilat konsistojnë në riparime, rikonstruksione të pjesshme ose të plota sipas kërkesave të paraqitura nga gjykatat. Një nga kërkesat e paraqitura është nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kërkesë në shumën 112,990 mijë lekë. Fondi i kërkuar nga kjo gjykatë nevojitet për realizimin e punimeve të rikonstruksionit në të gjitha ambientet e gjykatës për të mbështetur veprimtarinë e saj për periudhën tranzitore deri në sigurimin e akomodimit të ri. Preventivi i punimeve, i bazuar në projektin e zbatimit, është në vlerën 95,152 mijë lekë.

Gjykata ka paraqitur gjithashtu kërkesë për përshtatjen e dhomës së serverit. Kërkesa është shoqëruar me preventiv punimesh dhe vlera e fondit të kërkuar është 17,838 mijë lekë.

Kërkesë për rikonstruksion ka paraqitur edhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në shumën 1.700 mijë lekë edhe kjo për dhomën e serverit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka paraqitur kërkesë në shumën 7,200 mijë lekë edhe kjo për përshtatjen e dhomës së serverit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në shumën 2,365 mijë lekë për nevojat e rikonstruksionit të tarracës së godinës e cila është evidentuar se ka dëmtime të shumta në shtresa të hidroizolimit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka paraqitur kërkesë programuar në shumën 44,345 mijë lekë e cila konsiston në realizimin e punimeve të rikonstruksionit të godinës ekzistuese të gjykatës e cila shpreson në lirim të ambienteve që janë në përdorim nga disa institucione siç është edhe Njësia Bashkiake Kukës. Lidhur me këto të fundit sqarohet se janë 7 ambiente të cilat ndodhen në katin e parë të godinës, në gjendje të braktisur dhe me dëmtime të shumta. Kjo gjë do të bëjë kthimin në normalitet të punës në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës sidomos pas bashkimit me Gjykatën e Rrethit Tropojë.

Gjithashtu kërkesë për rikonstruksion ka paraqitur edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për të cilën është programuar shuma 13,000 mijë lekë për përshtatjen e dhomës së serverit.

Kodi i Projektit – Programe Software për gjykatat: Për vitin 2024 kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 357,800 mijë lekë, të ndara në nënartikullin

“Instalimi i sistemit të kompjuterëve” të cilat për vitin e parë të PBA-së kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 357,800 mijë lekë. Duhet të theksojmë se për të gjitha projektet investimeve të programuara për të filluar zbatimin gjatë vitit 2023, fondet buxhetore nga ana e MF janë çelur në fund të muajit prill 2023 edhe pse fondet për investime janë çelur me vonesë. Ndërsa fondet e detajuara për programet software për gjykatat janë çelur të ngrira në thesar. Pavarësisht dhënies së informacioneve shtesë mbi programet software të gjykatave të programuara për t’u realizuar gjatë vitit 2023, rëndësisë që kanë ato për sistemin gjyqësor, dhe kërkesave të vazhdueshme të bëra nga KLGJ-ja duke dërguar pranë MF disa shkresa për çlirimin e fondeve, përveç detajimit që kemi dërguar në dhjetor të 2022, nga ana jo për çlirimin e fondeve deri tani shpenzime kapitale për programet software ende nuk janë çelur plotësisht, duke ju vënë në dije se në datën 16 gusht 2023 u çelën një pjesë e fondeve që kanë të bëjnë me vazhdimin e projekteve ekzistuese nga viti 2022–2023. Mosçelja e plotë e fondeve ka sjellë mosfillimin për realizimin e projektit për ICMIS e ri.

Pavarësisht sa më sipër, kërkesat buxhetore të përgatitura nga ana jonë janë paraqitur duke marrë në konsideratë që fondet do të çlirohen dhe këto projekte të programuara për t’u realizuar gjatë vitit 2023, do të realizohen deri në fund të këtij viti buxhetor.

Në këto projekte përfshihen: Projekti për digjitalizimin e dosjeve të arkivit gjyqësor. Ky projekt ka filluar të implementohet që gjatë vitit buxhetor 2022 dhe gjatë vitit 2023. Vlera e mbetur e programuar për vitin 2024 është në shumën 38,600 mijë lekë;

Projekti për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili siç jeni në dijeni që është trajtuar në të gjitha fazat e hartimit të dokumentit të PBA-së, është mbështetur në Udhërrëfyesin me titull “Roadmap for the neë Case Management System”, “Udhërrëfyes për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore” i cili është miratuar me vendim të bordit të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë. Të gjithë jeni të njohur për rëndësinë që ka ky sistem por që siç e cituam më sipër, fondet për të, akoma edhe në këtë moment nuk janë çelur, janë çelur të ngrira në sistemin e thesarit nga ana e MF.

Ky projekt është programuar të realizohet në një periudhë 5-vjeçare në shumën prej 1,268,750 mijë lekë nga të cilat, shuma prej 1,059,950 mijë lekë është programuar të

financohet nga buxheti i shtetit, ndërsa për shumën prej 208,800 mijë lekë do të bëhet me financim të huaj bazuar në një dakordësi të një marrëveshjeje ndërinstitucionale me Ambasadën Suedeze dhe KLGJ-në, me qëllim financimin e kësaj shume. Projekti ishte programuar për të filluar implementimin në vitin 2023 në shumën prej 264,780 mijë lekë nga të cilat, shuma prej 212,000 mijë lekë e miratuar nga buxheti i shtetit dhe shuma prej 52,780 mijë lekë me financim të huaj. Sikurse cituam më sipër, fondet për këtë qëllim janë çelur të ngrira. Deri më tani akoma nuk na është çliruar fondi i detajuar për këtë qëllim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me gjithë insistimin tonë për realizimin e këtij projekti. Ndërsa për vitin 2024 ky projekt është programuar në shumën prej 449,450 mijë lekë nga të cilat, shuma prej 310,700 mijë lekë është programuar nga buxheti i shtetit dhe shuma prej 138,750 mijë lekë si financim i huaj, e kështu me radhë është programuar për vitin 2025, 2026 dhe për dy vitet e tjera në vazhdim, 2027. Ky projekt është i shtrirë në një periudhë 5-vjeçare.

Fonde kemi programuar edhe për projektin “Disaster Recovery” i cili ka filluar funksionimin që në vitin 2022 dhe kërkesat për vitin 2024 janë programuar në shumën 1,420 mijë lekë.

Gjithashtu edhe për projektin Infrastruktura mbështetëse për programin ICMIS i ri- i cili ka filluar që në vitin 2022 dhe për vitin 2024 kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 4,200 mijë lekë.

Po ashtu projekti i Regjistrimit të OJF-ve i cili ka filluar që në dhjetor të vitit 2022 dhe kërkesat buxhetore për vitin 2024 janë programuar në shumën 2,880 mijë lekë.

Kodi i Projektit “Blerje pajisje elektronike” - kërkesat buxhetore për vitin 2024 janë programuar në shumën 77,500 mijë lekë dhe që konsistojnë në “Instalim dhe pajisje telekomunikacioni” ku është programuar të blihen 6 servera për 5 gjykata; në blerjen e pajisjeve audio vizuale (Monitor, Aparat TV, Pajisje fonie, Diktofon, Sistem videokonference, Ekran interaktiv). Kërkesat buxhetore për këtë nënartikull janë programuar në shumën 9,320 mijë lekë dhe janë programuar të blihen për 6 gjykata;

Janë programuar gjithashtu në këtë kod projekti “Pajisje të tjera teknike” (Scanner, Router, Switch, Storage për server, Hard disk, Tablet). Janë programuar në shumën 9,440 mijë lekë. Do të përdoren për të plotësuar nevojat e 11 gjykatave.

Blerje “Pajisje fotokopje” - Kërkesat buxhetore për këtë nënartikull janë

programuar në shumën 4,670 mijë lekë. Janë programuar të blihen 8 pajisje fotokopje për zëvendësimin e pajisjeve ekzistuese për shkak të amortizimit dhe defekteve të tyre për 6 gjykata.

Nënartikulli “Pajisje kompjuterike” (blerje kompjuterësh dhe laptopë). Kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 39,490 mijë lekë, për plotësimin e nevojave për 17 gjykata.

Nënartikulli “Pajisje të tjera zyre” janë programuar në shumën 9,750 mijë lekë dhe janë programuar për të blerë printer, UPS, server, zëvendësim pajisjesh të tjera për nevojat e 16 gjykatave.

Kodi i projektit “Blerje pajisje zyre”, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 321,200 mijë lekë. Paraprakisht theksojmë se në kërkesat buxhetore të paraqitura nga gjykatat në fazën e dytë të PBA 2024-2026, është marrë në konsideratë dhe gjendja e pajisjeve mobileve të transferuara nga gjykatat që u mbyllën. Gjithsesi kërkesat për pajisje zyre dhe salle të paraqitura në fazën e dytë të PBA-së nga një numër i kufizuar gjykatash, kanë të bëjnë vetëm me rinovimin e pajisjeve ekzistuese.

Këtu përfshihen "Pajisje të tjera zyre", "Pajisje dhe instalim kondicioneri", "Pajisje për mbrojtjen kundra zjarrit".

Një pjesë të konsideruar në kërkesat buxhetore zë programi i sigurisë për gjykatat, programuar në shumën 281,600 mijë lekë.

Projekti i sigurisë për gjykatat, sikurse jeni në dijeni, ishte programuar të realizohej për vitin buxhetor 2023, por si rezultat i disa faktorëve objektivë, ky fond, me miratim të Këshillit të Lartë Gjyqësor iu ndryshua destinacioni dhe kaloi për blerjen e pajisjeve kompjuterike. Kështu që, për sa më sipër, nga struktura përgjegjëse e IT-së, u vlerësua që të paraqitet kosto e parashikuar gjatë BPA 2023-2025 të vitit të kaluar dhe duke programuar për vitin 2024 të njëjtën vlerë dhe të shtrirë realizimin e tij në dy vite buxhetore.

Kështu, për vitin 2024 vlera e projektit është programuar në shumën 273,300 mijë lekë dhe për vitin 2025 në shumën 173,100 mijë lekë. (bashkëlidhur keni dokumentacionin shoqërues nr.19).

Në këtë kod kemi programuar edhe për blerjen e disa pajisjeve të tjera të sigurisë, të cilat janë paraqitur nga katër gjykata, e cila është në shumën 8,300 mijë lekë.

Gjithashtu në pajisje zyre kemi përfshirë edhe kërkesat buxhetore për “Orendi zyre” (tavolina, karrige, etazherë, etj.) dhe kërkesat buxhetore janë për plotësimin e nevojave për 13 gjykata, në shumën 33,820 mijë lekë.

Kodi “Blerje mjete motorrike” - kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 24,400 mijë lekë dhe konsiston në blerjen e automjeteve dhe motoçikletave. Në blerjen e automjeteve për plotësimin e kërkesave të Gjykatës së Lartë e cila ka paraqitur kërkesë për pesë copë automjete dhe kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë e cila ka paraqitur kërkesë për tre automjete. Gjithashtu kemi programuar edhe për blerjen e dy motoçikletave për dy gjykata.

Për vitin 2025 kërkesat buxhetore në “Shpenzime kapitale” në këtë program janë programuar në total në shumën 2,013,880 mijë lekë dhe për vitin 2026, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 2,043,200 mijë lekë.

Këto ishin kërkesat buxhetore sipas dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 - 2026 (PBA 24-26) faza e dytë, për sistemin gjyqësor dhe pasqyrat përmbledhëse, sipas viteve buxhetore që të gjithë i keni bashkëlidhur.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të Këshillit shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 (PBA 24-26) faza e dytë, për sistemin gjyqësor, së bashku me pasqyrat përmbledhëse, bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, jam në pritje të ndonjë pyetje të mundshme nga ana juaj.

Faleminderit edhe një herë!

Naureda Llagami: Faleminderit Xhoda edhe një herë për relatimin e detajuar të çdo çështjeje të buxhetit.

Do doja nëse anëtarët/kolegët kanë ndonjë pyetje apo sqarim për këtë fazë të dytë?

Alban Toro: Mundem?

Naureda Llagami: Po, Alban!

Alban Toro: Nuk kisha pyetje, sepse këto ditë kam pasur mundësinë t'i ezauroj të gjitha pyetjet në mënyrë shteruese. E vetmja ndërhyrje që dua të bëj është, të përcjell dy shqetësime: i pari ndoshta është i përsëritur dhe ndoshta është bërë edhe shqetësim në Këshill në mbledhjet e tjera, ku bëhet fjalë për të gjitha ato gjykata ose më mirë të themi për ato struktura që do negociojnë në të ardhmen në ndërtimin e gjykatave, të marrin në konsideratë shqetësimin e Këshillit që infrastruktura gjyqësore mund të ndërtohet në truallin e gjykatës, kjo duhet të jetë e panegociueshme. Pra trualli i gjykatës, për shembull Gjykata e Apelit Tiranë e cila ka nevojë për një infrastrukturë të re ndërtimore, apo ajo e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjithashtu ka nevojë për një infrastrukturë të re ndërtimore, në të gjitha këto raste trualli i gjykatës do të ruhet dhe gjykata duhet të ndërtohet në këto troje. Ndërkohë që në raste specifike siç bie fjala për Gjykatën e Lartë ku infrastruktura gjyqësore ndërtimore është e pamjaftueshme të ndërtohet në sipërfaqen e trualli aktual, aty mund të cedohet dhe mund të transferohet në një sipërfaqe tjetër ku ekzekutivi do duhet ta kalojë, por gjithmonë jo larg qendrës së Tiranës (sepse dëshira mund të jetë edhe në Vorë), dhe të tentohet të ruhet gjithmonë akses i publikut në këto gjykata. Kjo në lidhje me shqetësimin e parë, i cili ka kaluar tashmë edhe në seanca të tjera të mëparshme dhe mendoj që është bërë edhe pjesë e shqetësimit të Këshillit.

Shqetësimi i dytë ka lidhje me një qasje krejtësisht negative që kam konstatuar në eksperiencën e këtyre viteve por edhe në këtë mbledhje të fundit ju do ta gjeni në faqen 35 të këtij relacioni, paragrafi i pestë, qasje jashtëzakonisht negative të ekzekutivit në lidhje me pavarësinë financiare të KLGJ-së. Më lejoni ta perifrashoj pjesën e këtij relacioni ku flitet: “Duhet të theksojmë se për të gjitha projektet e investimeve të programuara për të filluar zbatimin gjatë vitit 2023, fondet buxhetore janë çelur në fund të muajit prill 2023. Ndërsa fondet e detajuara për programet software për gjykatat janë çelur të ngrira. Pavarësisht dhënies së informacioneve shtesë mbi programet software të gjykatave të programuara për t’u realizuar gjatë vitit 2023, rëndësisë që kanë ato për sistemin gjyqësor, dhe kërkesave të vazhdueshme nga ana jonë për çlirimin e këtyre fondeve, deri tani fondet buxhetore në shpenzime kapitale për programet software të gjykatave ende nuk janë çliruar, duke vënë në rrezik mosrealizimin e tyre, mospërfundimin në kohë dhe brenda afateve të projekteve ekzistuese në vazhdim si dhe

mosfillimin e projekteve të reja.”.

Më lejoni të sjell një shembull nga analogët tanë. Para disa kohësh Presidenti i Gjykatës së Lartë të Ganës viziton Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara dhe ndër të tjera kërkon të dijë se si mbrohen dhe si janë zhvilluar të drejtat civile në Amerikë. Përgjigjja ishte laponike: Publiku amerikan bën atë që thotë Gjykata e Lartë. Natyrisht kjo tregon një autoritet jashtëzakonisht të lartë i cili ndër të tjera si komponent të tij ka edhe pavarësinë financiare. Natyrisht, e parë nga realiteti shqiptar, do thoni që ke përdorur sarkazëm duke përdorur një krahasim të tillë, por sarkazëm është edhe çelja e fondeve të ngrira. Nuk e di çfarë kuptimi do të gjente Ministria e Financave dhe ku e ka gjetur bazueshmërinë e veprimit për ta kryer një veprim të tillë, kur në ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e buxhetit” nuk ka absolutisht asnjë variant i cili do të pasqyronte këtë situatë financiare, pra çelje të fondeve të lira. Në kohën kur autoriteti publik financiar (që është Parlamenti) ka miratuar fondin buxhetor për ta përdorur KLGJ-ja, Ministria e Financave merr guximin dhe thotë unë do vazhdoj t’i mbajë të ngrira; unë i kam konsideruar të çelura (e konsideroj tallje), por janë të bllokuara për momentin.

Atëherë, duke u mundur të gjej çfarë përpjekjesh kemi bërë, bashkë me stafin, kam kërkuar të gjithë korrespondencën që kemi mbajtur me Ministrinë e Financave. Në të kam konstatuar që shkresat kanë qenë të hershme (duke filluar që vjet). Më lejoni t’i citoj disa: 6455/1, datë 29.12.2022, ku Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e buxhetit vjetor 2023, duke kërkuar miratimin e detajimit të fondeve me shpenzime kapitale dhe investime dhe reflektimi i tyre në sistemin e thesarit, me qëllim vazhdimin e procedurave për realizimin e investimeve për vitin 2023; me shkresën 6455/2, datë 24.03.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë miratimin e detajimit të fondeve në shpenzime kapitale dhe investime dhe reflektimin e tyre në sistemin e thesarit; me shkresën 2616/1, datë 28.04.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni Këshillit të Ministrave informacionin e kërkuar së bashku me dokumentacionin duke kërkuar edhe një herë çlirimin e fondeve buxhetore dhe reflektimin e tyre në sistemin e thesarit; me shkresën 2616/2, 31.05.2023, KLGJ-ja i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe për dijeni Këshillit të Ministrave, duke i kërkuar çlirimin e fondeve buxhetore dhe reflektimin e tyre në sistemin e thesarit; me shkresën

2616/3, datë 06.07.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke i kërkuar në mënyrë të përsëritur çlirimin e fondeve buxhetore dhe reflektimin në sistemin e thesarit.

Kjo sjellje e Ministrisë së Financave e cila në kohën kur autoriteti i mbikëqyrjes së financave publike, Parlamenti, ka miratuar një fond për t'u administruar, kjo e fundit merr guximin dhe nuk e autorizon përdorimin e tij. Pra në kushtet kur kufijtë buxhetorë nga ana e qeverisë asnjëherë nuk i janë përgjigjur nevojave të gjyqësorit të vlerësuar si e tillë nga ana jonë, ndërkohë që KLGJ-ja ka detyrimin kushtetues të planifikojë/të realizojë në mënyrë të duhur buxhetin duke siguruar funksionin efikas të gjykatave. Është kjo KLGJ që duhet të krijojë mekanizma që t'i përshtaten rrethanave të reja dhe sfiduese në një mënyrë efikase dhe në kohë, duke ruajtur funksionet thelbësore të gjykatave që tashmë janë krejtësisht të cenuara.

Nuk e di nëse keni parë tek Gjykata e Kukësit ka një konglomerat institucionesh brenda (është prokuroria e rrethit, përmbarimi, policia bashkiake), ndoshta do të ishte mirë të vendoset edhe një kopsht për ta bërë sa më dinamike panoramën brenda. Nuk e di nëse 245 punonjësit e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të mund të instalohen në atë lloj gjykate, kur tashmë është ndjerë uria për salla gjykimesh, siç ndihet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, apo siç ndihet në Gjykatën Administrative. Kjo është një situatë sarkastike ku nuk e di nëse mund të quhet nëse gjyqësori do të ruajë dot autoritetin apo do të zhvillojë një seancë solemne siç kërkohet.

Kështu që unë shikoj një mungesë vullneti dhe me të vërtetë e shikoj këtë vullnet, sepse ne rastet e tjera kur ka pasur vullnet, gjendja ka ndryshuar në mënyrë drastike. Edhe për këtë mund të sjell një ilustrim nga Banka e Shqipërisë i cili është një nga institucionet më të pavarura financiare në Republikën e Shqipërisë (në të gjithë drejtimit), megjithatë ajo u detyrua që në rast të pandemisë, siç është kjo pandemia jonë, të vepronte për të ulur limitin e likuiditetit të kompanive apo të merrte masa duke u kërkuar bankave të nivelit të dytë që të siguronin një pezullim të përkohshëm për klasifikimin e kredisë apo pezullimin e kësteve të kredisë deri në kalimin e gjendjes së emergjencës.

Pra kur ka një vullnet, konstatojmë që ka ndryshime. Në rastin konkret unë shikoj

që nuk ka asnjë lloj vullneti, me gjithë përpjekjet e bëra nga stafi për të sensibilizuar aktorët financiar (situata është e njëjta), kështu që edhe përgjigjja dhe kundërpërgjigjja jonë do të jetë akoma për një (*nuk kuptohet fjala*) ... më të lartë.

Kështu që unë mendoj, propozoj që t'i dërgohet shkresë Komisionit Parlamentar që merret me ekonominë, pra Parlamenti që është mbikëqyrësi i vetëm financiar publik të fondeve publike, duke i kërkuar ndihmë për zgjidhjen e kësaj situatë dhe për heqjen e pengesave i që bëhet autoriteteve financiare të KLGJ-së. Gjithashtu të nxirret edhe një deklaratë në faqen tonë ku të evidentohen vështirësitë që kemi ndeshur në qasjen negative të ekzekutivit në dëm të interesave të gjyqësorit dhe ndoshta në këto dy aspekte do të përmirësojmë sado pak dhe do kemi rezultate të përpjekjeve tona për të qenë vërtetë të pavarur financiarisht (për aq sa është relative kjo shprehja) dhe t'i përgjigjemi kërkesave të publikut për të pasur një gjyqësor të fortë, të pavarur, etj., etj. Ndoshta në të ardhmen do duhet të mendojmë që në ndryshimet ligjore të përfshijmë dispozita ku intelektualori i vetëm për buxhetin të mos jetë Ministria e Financave, por të jetë Komisioni Parlamentar i Ekonomisë, siç është rasti i Hungarisë, ku nga ky ndryshim është përmirësuar në të dukshëm pavarësia e gjyqësorit në Hungari.

Faleminderit dhe ju kërkoj ndjesë për këtë ligjëratë të gjatë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit Alban!

Nuk dua të heq asnjë presje nga ato që the, sepse ne gjatë gjithë kësaj periudhe jemi munduar që jo vetëm të ndërgjegjësojmë Ministrinë e Financave, por edhe Këshillin e Ministrave, duke qenë se Kuvendi në thelb na e dha të drejtën, pasi me ligj buxheti u miratua (të ardhurat). Dhe këtu ndaj të njëjtin mendim si ju sikurse dhe stafi dhe gjithë departamenti që njoftimi është një gjë e paprecedent, por kjo nuk është hera e parë që i ndodh sistemit, edhe vjet na ka ndodhur e njëjta situatë. Patjetër që ne do ta adresojmë, ashtu siç juve sugjeroni, dhe pse jo, në shkresën e radhës që do të bëjmë për kujtesë, do t'ia çojmë edhe Kuvendit për dijeni, duke qenë se ne tashmë kemi edhe raportimin para Kuvendit mbi buxhetin dhe do jetë pjesë më pas edhe e një deklaratë ku mund të shkojë edhe në Kuvend për të diskutuar mbi çështjen e buxhetit dhe mosreagimi për katër muaj rresht i Ministrisë së Financës mbi këtë bllokim të paligjshëm.

Kështu që, nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër (këto sugjerime Alban do t'i kryejmë nga stafi) kalojmë në votimin e projektbuxhetit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), faza e dytë, për sistemin gjyqësor (Këshillin e Lartë Gjyqësor, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe Gjykatat), sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen e sotshme, duke ju uruar të gjithë kolegëve faleminderit për pjesëmarrjen dhe pushime të mbara.

Mirupafshim!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor